

Siguri

Ekskluzive | 16-vjeçari i dehur dyshohet se kanosi dy persona me pistoletë në Ferizaj, përfundon në ndalim



Sinjali.com

09 Korrik 2026 08:48



Një incident me armë ka alarmuar mbrëmjen e së martës qytetin e Ferizajt, ku një i mitur dyshohet se ka kanosur dy persona me një pistoletë, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se ngjarja ka ndodhur më 8 korrik, rreth orës 23:30, në rrugën “Ahmet Kaçiku”.

Pas marrjes së informacionit për një rast të kanosjes me armë zjarri, njësitet policore kanë reaguar menjëherë dhe kanë identifikuar personat e përfshirë në incident.

Sipas burimeve, i dyshuari është F.A. (16 vjeç), ndërsa viktima në këtë rast janë A. Dullovi (40 vjeç) dhe D. Behluli (26 vjeç).

Gjatë kontrollit, Policia i ka gjetur të miturit një pistoletë të tipit “Walther”, që dyshohet të jetë me gaz, së bashku me një karikator dhe gjashtë fishekë, të cilat dyshohet se janë përdorur për t’i kanosur viktimat.

Dy të dëmtuarit janë intervistuar në stacion policor, ndërsa i dyshuari nuk ka mundur të merret në pyetje, pasi sipas burimeve ka qenë nën ndikimin e alkoolit.

Me vendim të Prokurorit kujdestar, 16-vjeçarit i është caktuar masa e ndalimit për 24 orë, ndërsa ndaj tij është iniciuar procedurë për veprat penale “Kanosja” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Rasti po hetohet nga organet kompetente.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera